



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit/ Opština Dragaš/ Dragash Municipality
Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport



Datë: 19/01/2024

Dragash

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragaš

11 Nr. Br. 100/01-2135/24
19-01 2024
Dragash - Dragaš

THIRRJE PUBLIKE

Të gjitha organizatave joqeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës që veprojnë në Komunën e Dragashit, programi i punës i së cilave është i fokusuar në fushën e Kulturës dhe që përfshijnë aktivitete të realizuara në Komunën e Dragashit, që të aplikojnë për mbështetje financiare:

- **NË FUSHËN E KULTURËS**
 - **MANIFESTIMET E KOMUNËS, VLERAT KULTURORE DHE RUAJTJA E FOLKLORIT**

Vlerësimi:

Vlerësimi profesional do të bëhet nga Komisioni profesional prej pesë (5) anëtarësh, të cilët do t'i vlerësojnë projektet në bazë të kriterëve për vlerësim dhe sipas Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

Vlerësimi do të bëhet sipas:

1. Plotësimi të kushteve administrative të aplikimit;
2. Ndërlidhjes me objektivat e thirrjes;
3. Kapacitetit të dëshmuar organizativ dhe menaxhues;

4. Vazhdimësisë së realizimit të programit për afirmimin ndërkombëtar të Komunës së Dragashit;
5. Cilësisë së projektit; dhe
6. Originalitetit të projektit.

Dokumentet që duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve janë:

1. Formulari i aplikacionit për projekt/program;
2. Formulari i propozim-buxhetit;
3. Formulari i deklaratës për mungesë të financimit të dyfishtë;
4. Formulari për konflikt interesi;
5. Dokumenti i identitetit (fotokopje);
6. Certifikata e regjistrimit të OJQ-së dhe Numri Fiskal (fotokopje);
7. Konfirmim nga banka për xhirrollogarinë e aplikuesit;
8. Vërtetim mbi kryerjen e të gjitha detyrimeve tatimore ndaj ATK-së, jo më të vjetër se 6 muaj; dhe
9. Dëshmi të implementimit të projekteve/ programeve të ngjashme.

Formulari për aplikim mund të merret në uebfaqen e Komunës dhe mund të dorëzohet nga **19/01/2024 deri më 08/02/2024** (15 ditë punë). Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen!

Dokumentet e kompletuara në kopje fizike dhe CD duhet të dorëzohen te Zyra e Protokollit (Arkivi) Nr. 1, në ndërtesën e Komunës së Dragashit, për Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport.

Aplikimet

1. **OJQ-të në kuadër të kësaj Thirrjeje mund të aplikojnë më së shumti me një projekt.**
2. Të drejtë aplikimi kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave joqeveritare në Republikën e Kosovës, të cilat veprojnë në territorin e Komunës së Dragashit dhe të cilat merren me aktivitete në fushën e kulturës, rinisë e turizmit.
3. Aplikuesit duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e

aplikimit.

4. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente, sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovë dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë të përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj Komunës së Dragashit - Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe të gjithë ofruesve të tjerë të mbështetjes financiare publike.
5. Propozimet duhet të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me udhëzimet për aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare të Komunës së Dragashit.
6. Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

Vërejtje:

Projektet të cilat nuk i kanë të bashkëngjitura dokumentet sipas kërkesës nuk do të merren parasysh nga Komisioni për shqyrtimin e kërkesave. Për çdo informatë dhe për të gjitha çështjet që lidhen me Thirrjen publike mund të sqarohen në Drejtorinë për Kulturë, Rini e Sport!

Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport

Drejtoresha

Ljridona Misinaj

